



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe  
Teknologjisë*

**fhi360**  
THE SCIENCE OF IMPROVING LIVES

## Basic Education Program

# UDHËZUES STANDARDET E VLERËSIMIT



Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjensionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Udhëzuesi është financuar nga populli amerikan përmes Agjensionit të SHBA-së për zhvillim ndërkombëtar - USAID Kosovë, në kuadër të Programit për arsimin themelor të cilin e zbaton Family Health International(FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencave dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT).



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria –Vlada-Government**

**Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje  
Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology**

**Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister**

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet; 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar (Gazeta Zyrtare nr. 17, dt. 16 shtator 2011), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcën 6 dhe neni 33.2 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr :

**UDHËZUES**

**STANDARDET E VLERËSIMIT**

**NUMËR: 490/ 01 B**

**DATË: 23.12.2012**

## NENI 1

### Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është zbatimi i standardeve të vlerësimit për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe përcjelljes në ngritjen e performancës së nxënësve në arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës.

## NENI 2

### Përmbajtja

1. Udhëzuesi përmban standarde të përgjithshme dhe të veçanta, parimet e vlerësimit, planifikimin e vlerësimit, përzgjedhja e metodave dhe instrumenteve për vlerësim, realizimin e vlerësimit, notimin dhe sigurimin e informacioneve të nxjerra nga vlerësimi.
2. Standardet e vlerësimit me bazë në shkollë përbëjnë një spektër të gjerë e të gjithanshëm të kritereve relevante, me rëndësi për vlerësim, si dhe një mjet vlerësimi praktik dhe të përdorshëm.

## NENI 3

### Parimet

- 1. Vlerësimi para së gjithash ka për qëllim të nxënësve dhe të arriturat e nxënësve**
  - 1.1. Përmes vlerësimit nxënësit marrin informacion për atë që do të duhet ta mësojnë. Sa do të mësojnë dhe si do të mësojnë, kjo në masë të madhe varet nga vlerësimi që zbatohet.
  - 1.2. Vlerësimi shërben që ta nxisë nxënësin të mësojë dhe t'i japë udhëzime se si duhet të mësojë në mënyrë që t'i përmirësojë të arriturat në mësim dhe jashtë tij. Vlerësimi nuk shërben vetëm që ta vërtetojë se sa ka arritur nxënësi të mësojë.
- 2. Vlerësimi siguron informacione të plota për të arriturat e nxënësve**
  - 2.1. Me vlerësim sigurohen informacionet për atë që nxënësit e dinë dhe çka janë në gjendje të bëjnë me atë që dinë.
  - 2.2. Me vlerësim, verifikohen dituritë dhe aftësitë e nxënësve si dhe vlerat, qëndrimet dhe shprehjet e tyre, që njëherit ndikojnë edhe në suksesin që e arrijnë në shkollë dhe jashtë shkollës.
  - 2.3. Me vlerësim merren informacione edhe për anët e forta dhe ato të dobëta të nxënësve, që pastaj përdoren për të siguruar përparimin në të arritura e tyre.
- 3. Vlerësimi është pjesë përbërëse e procesit mësimor (në mësimdhënie dhe nxënie)**
  - 3.1. Ekziston lidhje e qartë ndërmjet qëllimeve dhe përmbajtjeve të të nxënësve dhe vlerësimit (ndërmjet asaj që mësohet e që ofrohet si mësim dhe asaj që vlerësohet).

- 3.2. Mësimdhënia, nxënia dhe vlerësimi janë procese të ndërthurura dhe sigurojnë koherencë në mësim.
- 3.3. Nga qëllimet dhe përmbajtjet mësimore varet çka do të vlerësohet. Nga rezultati i vlerësimit varet si do të zhvillohet mësimi dhe drejt cilave qëllime synon të ecën dhe të arrihet.
- 3.4. Nxënësi dhe mësimdhënësi kanë rol aktiv në procesin e vlerësimit.

#### **4. Vlerësimi bazohet në përdorimin e më shumë metodave të ndryshme**

- 4.1. Përdorimi i sa më shumë të metodave të ndryshme të vlerësimit mundëson që të zvogëlohen dobësitë dhe kufizimet e secilës metodë veçmas.
- 4.2. Kur përdoren më shumë metoda të ndryshme të vlerësimit, vlerësimi i merr parasysh stilet e ndryshme të të nxënësve.

#### **5. Vlerësimi është proces i vazhdueshëm**

- 5.1. Vlerësimi përfshin aktivitetet përcjellëse të punës, rezultatet e vlerave të saj dhe të arriturave të nxënësve gjatë tërë vitit shkollor.
- 5.2. Gjatë vlerësimit kontrollohet përparimi i të arriturave të nxënësve në bazë të asaj sesi orientohen nxënësit drejt qëllimeve të parashtruara në mësim.

#### **6. Vlerësimi është i drejtë**

- 6.1. Vlerësimi është i drejtë në qoftë se i referohet paanshmërisë gjatë zbatimit të vlerësimit në të arriturat e nxënësve, interpretimit dhe përdorimit të rezultateve.
- 6.2. Vlerësimi nuk favorizon (as sipas mënyrës, as sipas përmbajtjes) nxënës në bazë të prejardhjes së tyre, gjinisë së tyre, dhe as në bazë të përvojave të tyre të mëparshme me mësimdhënës dhe/ose me metodën e vlerësimit.

#### **7. Vlerësimi është transparent**

- 7.1. Vlerësimi është transparent në qoftë se nxënësit dhe prindërit kanë qasje në vlerësim (në metodat që do të përdoren dhe në rezultatet e përdorimit të tyre).
- 7.2. Nxënësit e dinë se çka dhe cilat janë qëllimet e të nxënësve, cilat janë standardet që priten prej tyre t'i arrijnë dhe si do të vlerësohet arritja e tyre (ajo që duhet ta mësojnë, si dhe kur do të vlerësohen).

#### **8. Vlerësimi është i vlefshëm dhe i sigurt**

- 8.1. Vlerësimi është i vlefshëm në qoftë se përmes tij merren informacione që janë relevante për qëllimet dhe përmbajtjet e vlerësimit.
- 8.2. Në interpretimin e rezultateve të vlerësimit nuk bëjnë pjesë gjykimet për sjelljen, aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve, që nuk janë objekt i vlerësimit konkret.
- 8.3. Vlerësimi është i njëjtë për të gjithë nxënësit si dhe nga të gjithë mësimdhënësit.

## **NENI 4**

### Standardet e vlerësimit

#### **1. Standardi i parë: PLANIFIKIMI I VLERËSIMIT**

##### **1.1. Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e planifikimit të punës së shkollës**

1.1.1. Në mënyrë që të sigurohet se të nxënit e nxënësve dhe arritjet e tyre vlerësohen në mënyrë të drejtë të përshtatshme dhe rezultatet e atij vlerësimi përdoren me qëllim të përmirësimit të të nxënit, vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e procesit të planifikimit në nivel të shkollës, aktiveve (këshillave) profesionale dhe mësimdhënësve individual.

##### **1.2. Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e planit zhvillimor të shkollës dhe e planit vjetor të shkollës**

1.2.1. Secila shkollë duhet ta ketë një politikë të shkruar për vlerësimin në nivel të shkollës (d.m.th, që të mbulojë edhe vlerësimin e të nxënit (ViN) (vlerësimin përmbledhës), edhe vlerësimin për nxënie (VpN) (vlerësimin formativ), si dhe Kodin e Etikës për Vlerësim me bazë në shkollë.

1.2.2. Politika e shkollës për vlerësim duhet të jetë në përputhje me Kornizën e Kurrikulës, parimet dhe standardet e përcaktuara nga MASHT dhe Autoritetet Komunale të Arsimit për vlerësimin në nivel të shkollës.

1.2.3. Politika e vlerësimit duhet të përfshijë: përzgjedhjen e metodave të vlerësimit si dhe zhvillimin e instrumenteve; realizimin e vlerësimeve; klasifikimin dhe dhënien e informacionit që del nga gjetjet e procesit të vlerësimit, me rezultate të ndara edhe në baza gjinore.

1.2.4. Secila shkollë duhet rregullisht ta kryejë monitorimin për kapacitetet dhe praktikën e saj të vlerësimit, në mënyrë që të çojë drejt një plani të veprimit për të forcuar vlerësimin në përputhje me politikën e shkollës.

1.2.5. Të gjitha vlerësimet e të nxënit dhe për nxënie në të gjitha fushat mësimore duhet të planifikohen në nivel shkollë.

##### **1.3. Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e planeve të punës së mësimdhënësve, aktiveve (këshillave) profesionale dhe shërbimeve profesionale të shkollës.**

1.3.1. Mësimdhënësit duhet të veprojnë bashkërisht si aktiv (këshill) profesional për të planifikuar: përzgjedhjen e metodave dhe zhvillimin e instrumenteve të vlerësimit; realizimin e vlerësimeve; notimin, klasifikimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit rreth rezultateve, në përputhje me politikën e vlerësimit të shkollës.

1.3.2. Shërbimi profesional i shkollës dhe aktivitet (këshillat) profesionale duhet të planifikojnë: si të sigurohet cilësia e aktiviteteve të vlerësimit në shkollë; dhe si të sigurohet përkrahje profesionale për grupet e mësimdhënësve sipas lëndëve, dhe mësimdhënësve individual për çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin.

**1.4. Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e planeve vjetore, planeve mujore dhe ditore të mësimdhënësve.** Mësimdhënësit duhet ta planifikojnë vlerësimin e të nxëniet (ViN) në përputhje me politikën e shkollës dhe rezultatet e pritshme të caktuara në kurrikulë:

- 1.4.1. Planifikimi i mësimdhënësit për vlerësimin e të nxëniet duhet t'i kushtojë vëmendje: përzgjedhjes së metodave të vlerësimit dhe zhvillimit të instrumenteve; realizimit të vlerësimit; klasifikimit dhe dhënies së informacionit nga gjetjet e vlerësimit.
- 1.4.2. Mësimdhënësit duhet ta planifikojnë vlerësimin për nxëniet si pjesë përbërëse të mësimdhënies dhe nxënies.
- 1.4.3. Në planifikimin për vlerësimin për nxëniet, mësimdhënësi duhet t'i kushtojë vëmendje: vlerësimit që kërkohet para të nxëniet, gjatë të nxëniet dhe pas procesit të të nxëniet.
- 1.4.4. Në planet e mësimin si dhe gjatë orës mësimore, mësimdhënësi duhet t'i marrë parasysh karakteristikat themelore të vlerësimit për nxëniet: ndarjes së objektivave (qëllimeve të të nxëniet) dhe kritereve të suksesit, së bashku me nxënies; procesin e të pyeturit; vëzhgimin dhe teknikat për dhënien e informatës kthyesë; vetëvlerësimin dhe vlerësimin e ndërsjellë (bashkëmoshatarët).
- 1.4.5. Të dhënat (të ndara në baza gjinore) që dalin nga procesi i vlerësimit për nxëniet duhet të përdoren nga mësimdhënësit për t'u riplanifikuar në aktivitetet në mësimdhëniet me qëllim që t'u ndihmojnë nxëniesve në përmirësimin e të nxëniet në të ardhmen.

## **2. Standardi i dytë: PËRZGJEDHJA E METODAVE TË VLERËSIMIT DHE ZHVILLIMI I INSTRUMENTEVE**

**2.1. Metodave vlerësimit duhet të jenë të përshtatshme për qëllimet dhe kontekstin e vlerësimit.** Të nxëniet dhe arritjet e nxëniesve duhet të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme duke përdorur metodat dhe instrumentet më të përshtatshme. Në mënyrë që të sigurohet kjo, mësimdhënësit duhet ta zbatojnë vlerësimin për nxëniet dhe t'i zhvillojnë instrumentet të cilat janë të përshtatshme për këtë qëllim.

**2.2. Rezultatet e pritshme mësimore të kurrikulës duhet të jenë bazë e të gjitha vlerësimeve.**

- 2.2.1. Rezultatet mësimore specifike të përcaktuara në kurrikulë duhet të përkufizohen nga pikëpamja e aktivitetit – d.m.th, çfarë duhet të vlerësohet dhe si mund të mblidhen informatat. Ky përkufizim i aktivitetit duhet të jetë baza e secilit vlerësim.
- 2.2.2. Mësimdhënësit duhet t'i dinë rezultatet specifike mësimore që kanë të bëjnë me një fushë të caktuar, lëndë, apo njësi mësimore dhe t'i përdorin mënyrat e përshtatshme për vlerësimin e tyre.
- 2.2.3. Mësimdhënësit duhet gjithnjë të zhvillojnë dhe të përzgjedhin instrumente dhe metoda të vlerësimit që janë të përshtatshme për qëllime të vlerësimit të rezultateve mësimore të kurrikulës.

### **2.3. Rezultatet specifike mësimore duhet të vlerësohen**

- 2.3.1. Rezultatet mësimore të kurrikulës duhet të vlerësohen në të gjitha fushat, (e dijes, psikomotorike dhe afektive (emocionale)).
- 2.3.2. Sa i përket numrit të pyetjeve/detyrave (kërkesave), më shumë peshë duhet t'u jepet rezultateve mësimore të cilat janë më komplekse apo të cilave u jepet më shumë kohë gjatë mësimdhënies.
- 2.3.3. Mësimdhënësit duhet të dinë si ta hartojnë një skemë të vlerësimit për një fushë, lëndë, apo njësi mësimore të caktuar.
- 2.3.4. Mësimdhënësit duhet të dinë si ta zhvillojnë një specifikim për një vlerësim të veçantë si dhe të sigurohen se vlerësimi e përmbush specifikimin.
- 2.3.5. Gjatë përzgjedhjes së instrumenteve të vlerësimit, mësimdhënësit duhet që gjithnjë ta ndjekin skemën e përgjithshme të vlerësimit dhe specifikimit për vlerësimin e veçantë si dhe ta vërtetojnë se instrumenti përputhet me skemën e vlerësimit dhe specifikimit.

### **2.4. Metodatat e vlerësimit dhe instrumentet e ndryshme që duhet të përdoren**

- 2.4.1. Mësimdhënësit duhet gjithnjë ta kenë parasysh se nxënësit kanë nivele të ndryshme të të kuptuarit. Prandaj, vlerësimi i nxënësve kërkon që të përdoren një sërë metodash me nivele të ndryshme të kompleksitetit dhe vështirësisë.
- 2.4.2. Mësimdhënësit duhet ta kenë parasysh se nxënësit me inteligjencë dhe personalitete të ndryshme mësojnë në mënyra të ndryshme, ndaj një instrument i vlerësimit nuk do të jetë i njëjtë dhe i drejtë për të gjithë. Përdorimi i shumë instrumenteve për të vlerësuar një rezultat mësimor (të pritshëm) bën të mundur që një grup më i madh i nxënësve t'i tregojnë arritjet e tyre të vërteta.
- 2.4.3. Mësimdhënësit duhet të identifikojnë, zhvillojnë dhe përdorin instrumente të ndryshme të vlerësimit në mënyrë që të gjithë nxënësve t'u mundësohet t'i shprehin tërësisht arritjet e tyre.

### **2.5. Metodatat e vlerësimit dhe instrumentet e përdorura duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin për të cilin do të përdoren**

- 2.5.1. Mësimdhënësit duhet ta kenë parasysh rëndësinë e vlerësimit të rezultateve mësimore në mënyrën më të drejtpërdrejtë të mundshme, pasi që vlerësimet e tërthorta, edhe nëse janë simulime apo aktrime, vlerësojnë vetëm ndërlidhje të asaj që duhet të vlerësohet dhe kanë prirje ta deformojnë mësimdhënien dhe nxënien.
- 2.5.2. Mësimdhënësit duhet që gjithnjë të përzgjedhin apo zhvillojnë instrumente të vlerësimit që janë të përshtatshme me natyrën e rezultatit mësimor (aftësitë e të dëgjuarit duhet të vlerësohen me instrumente që kanë për bazë shkathtësitë praktike për të dëgjuarit).
- 2.5.3. Në vlerësimin për nxënie, detyra të duhura janë ato që sigurojnë informacion me theks mbi procesin dhe jo vetëm mbi përgjigjen e saktë.
- 2.5.4. T'i kushtohet kujdes gjuhës dhe ndjeshmërisë gjinore si dhe të shmangen stereotipet e mundshme.

## **2.6. Metodatat e vlerësimit dhe përdorimi i instrumenteve duhet të jenë të vlefshme dhe të besueshme, si dhe të përzgjidhen në harmoni me qëllimin që ka ai vlerësim**

- 2.6.1. Mësimdhënësit duhet ta dinë dhe ta kuptojnë konceptin themelor të vlefshmërisë, llojet kryesore të vlefshmërisë si dhe si të vlerësojnë dhe rrisin vlefshmërinë e një vlerësimi të caktuar.
- 2.6.2. Mësimdhënësit duhet ta dinë dhe ta kuptojnë konceptin themelor të besueshmërisë, burimet kryesore të jobesueshmërisë dhe si të shfrytëzohet maksimalisht besueshmëria e një vlerësimi të posaçëm.
- 2.6.3. Gjatë përgatitjes së hartimit të një vlerësimi specifik, mësimdhënësit duhet që gjithnjë t'i kushtojnë vëmendjen e duhur përzgjedhjes së teknikave dhe zhvillimit të instrumenteve specifike që janë sa më të besueshme që është e mundur si dhe të krijojnë nivelet e duhura të vlefshmërisë për qëllimin për të cilin bëhet vlerësimi.

## **3. Standardi i tretë: REALIZIMI I VLERËSIMIT**

### **3.1. Vlerësimi duhet t'ua mundësojë nxënësve që të demonstrojnë njohuri, aftësi, shkathtësi qëndrime dhe vlera.**

- 3.1.1. Gjatë procesit të vlerësimit për nxënie (vlerësimi formativ), mësimdhënësit duhet t'i dinë dhe t'i ndjekin rregullat dhe parimet e praktikave efektive të atij vlerësimi.
- 3.1.2. Gjatë kryerjes së procesit të vlerësimit të nxënies (vlerësimi përmbledhës), shkollat dhe mësimdhënësit duhet t'i ndjekin parimet e praktikave të mira, efektive dhe çdo procedurë, rregullore, standard që është planifikuar në planin zhvillimor të shkollës, dhe që është përcaktuar për ekzaminim të veçantë.
- 3.1.3. Udhëheqësit e shkollës duhet të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe ta verifikojnë realizimin e atyre praktikave.

### **3.2. Nxënësit duhet të informohen në lidhje me vlerësimin, pse ata do të vlerësohen dhe se si do të përdoren rezultatet e vlerësimeve**

- 3.2.1. Nxënësit duhet të informohen paraprakisht se si do të vlerësohen (puna/përgjigjet e tyre) dhe të bëhen të qarta objektivat dhe kriteret që do të zbatohen gjatë procesit të vlerësimit.
- 3.2.2. Nxënësit duhet të njoftohen rreth ndryshimeve që janë bërë në procedurën për vlerësim para se ato të zbatohen.
- 3.2.3. Nxënësve duhet t'u jepen shembuj (modele) të përgjigjeve të vlerësuara (punime, projekte, teste) me shpjegime të përshtatshme se pse ato janë vlerësuar në atë mënyrë.

### **3.3. Vlerësimi për nxënie (VpN) duhet të jetë plotësisht i integruar në programin mësimor**

- 3.3.1.Mësimdhënësit duhet t'i dinë dhe t'i kuptojnë parimet themelore dhe teknikat kryesore të vlerësimit për nxënie (vlerësimit formativ).
- 3.3.2.Rezultatet e vlerësimit për nxënie (VpN) kryesisht përdoren në mënyrë diagnostifikuese dhe jo për raportim të pikëve apo notim.
- 3.3.3.Të nxënit e mëhershëm duhet të vlerësohet si pikënisje për planifikimin e programit mësimor.
- 3.3.4.Qëllimet e të nxënit duhet t'u tregohen nxënësve që në fillim të mësimit, në gjuhën që ata e kuptojnë. Këto qëllime duhet të jenë bazë për pyetje, kërkesa dhe përgjigje.
- 3.3.5.Kriteret e suksesit duhet t'u tregohen nxënësve dhe të ndërlidhen me qëllimet e të nxënit si dhe duhet t'u tregohen shembuj (modele) të punimeve që kanë plotësuar kriteret, bashkë me shpjegime dhe sqarime, të cilat i orientojnë ata drejt pritjeve të qarta të përbashkëta.

### **3.4. Në vlerësimin për nxënie nxënësit duhet të luajnë një rol aktiv**

- 3.4.1.Mësimdhënësit duhet ta dinë dhe ta kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në planifikimin e programit të tyre të mësimit, duke i monitoruar arritjet e tyre dhe duke marrë pjesë në caktimin e qëllimeve të rishikuara.
- 3.4.2.Mësimdhënësit duhet ta inkurajojnë vetëvlerësimin e nxënësve, si dhe vlerësimin e ndërsjellë (njëri-tjetri). (Mësimdhënësit duhet të kenë kujdes që vetëvlerësimi dhe vlerësimi i ndërsjellë të jetë korrekt dhe i drejtë nga të dy gjinitë).

### **3.5. Vlerësimi i të nxënit (vlerësimi përmbledhës) duhet të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore dhe udhëzimet e nxjerra nga MASHT-i**

- 3.5.1.Mësimdhënësit duhet t'i dinë dhe t'i kuptojnë dispozitat ligjore të MASHT-it si dhe standardet relevante për cilindo vlerësim që bëjnë.
- 3.5.2.Të gjitha vlerësimet duhet t'u përmbahen dispozitave ligjore dhe standardeve të notimit të përcaktuara nga MASHT-i, si dhe t'u përmbahen politikave të shkollës për procesin e vlerësimit.

### **3.6. Kushtet në të cilat bëhet vlerësimi duhen të jenë të përshtatshme për qëllimin dhe metodat e përdorura**

- 3.6.1.Shkolla duhet të sigurojë një ambient për vlerësim që respekton personalitetin e nxënësit dhe nuk shkakton pakënaqësi apo ndjenja të pakëndshme.
- 3.6.2.Vlerësimi për nxënie (vlerësimi formativ) duhet të ketë gjithnjë vend në një mjedis përkrahës. Dhënia e komenteve duhet të bëhet në lidhje me cilësinë e punimit dhe të ketë këshilla specifike se çfarë nevojitet të bëhet për përmirësim. Nxënësve u duhet dhënë kohë të veprojnë sipas këshillave dhe të marrin vendime për punën e tyre, jo të jenë pranues pasiv të gjykimeve të mësimdhënësve. Vlerësimet duhet të bëhen në një ambient që ua mundëson nxënësve të prezantojnë lirshëm dhe pa frikë dobësitë dhe vështirësitë e tyre në të nxënit.

- 3.6.3.Vlerësimi i të nxënit (vlerësimi përmbledhës) duhet të bëhet gjithnjë në kushte që nuk i pengojnë nxënësit që t'i shfaqin arritjet e tyre (nuk duhet të ketë zhurmë të tepërt, të jetë nxehtë apo ftohtë gjatë kohës, nuk duhet të kenë mundësi të kopjojnë apo mashtrojnë gjatë vlerësimit).
- 3.6.4.Nxënësit duhet t'i kenë edhe burimet, por edhe kohën e nevojshme për ta bërë detyrën, kërkesën që të vlerësohen në nivelin më të lartë të mundshëm (detyrat,(kërkesat) nuk duhet të kërkojnë asnjë burim që nxënësit nuk e kanë, njohuri, përmbajtje apo koncept që nuk iu është mësuar).
- 3.6.5.Udhëzimet që kanë të bëjnë me vlerësimin duhet të jenë të qarta, të plota dhe të përshtatshme për moshën dhe për aftësitë e nxënësit.
- 3.6.6.Gjatë procesit të vlerësimit të nxënësve me nevoja të veçanta duhet të përgatiten udhëzime të posaçme që u përshtaten aftësive të tyre.

### **3.7. Të gjithë nxënësit duhet të kenë trajtim të drejtë dhe të barabartë**

- 3.7.1.Shkolla duhet të zhvillojë dhe praktikojë mekanizma që pengojnë presionin nga ana e prindërve, nxënësve dhe palëve të tjera të interesit si dhe t'i përkrahin mësimdhënësit për t'i rezistuar një presioni të tillë.
- 3.7.2.Të gjithë nxënësve u duhet dhënë mundësitë që t'i demonstrojnë tërësisht aftësitë e tyre me anë të detyrave, kërkesave që kanë nivele të ndryshme të kompleksitetit.
- 3.7.3.Mësimdhënësi duhet të krijojë ambient mbështetës për të gjithë nxënësit gjatë procesit të vlerësimit dhe jo të favorizojë apo injorojë ndonjërin në baza nacionale, gjinore, fetare, sociale, etj.

### **3.8. Shkolla duhet të ketë një sistem për të verifikuar dhe për të siguruar cilësi në kryerjen e vlerësimit të të nxënit (vlerësimit përmbledhës)**

- 3.8.1.Si pjesë e planit zhvillimor të shkollës, shkollat duhet të zhvillojnë dhe implementojnë një sistem për verifikim të brendshëm të vlerësimit, me role të përcaktuara dhe personel të kualifikuar. Ky sistem kontrollon instrumentet vlerësuese sipas standardeve, kriterëve dhe i kontrollon kushtet dhe procedurat për administrim.
- 3.8.2.Verifikimi i vlerësimit të brendshëm duhet të udhëhiqet nga shërbimet profesionale të shkollës (pedagog-psikolog), si dhe duhet t'i përfshijë aktivitet (këshillat) profesionale shkollore të mësimdhënësve.
- 3.8.3.Pas secilit vlerësim sumativ apo përmbledhës (të brendshëm), në fund të semestrit apo në fund të vitit shkollor, verifikuesit e brendshëm nxjerrin një raport mbi cilësinë e vlerësimeve të kryera.

## **4. Standardi i katërt: NOTIMI**

- 4.1. Dhënia e notës për arritjet e nxënësit duhet t'i pasqyrojë arritjet reale të tij/saj dhe të jetë në përputhje me synimet e kurrikulës (programeve lëndore mësimore) për periudhën e vlerësuar.
- 4.2. Në rastet kur vlerësimi është përdorur në mënyrë formësuese (VpN), një raport përshkrues mund të jetë më i dobishëm se një notë, kështu që nota duhet të caktohet vetëm kur është e nevojshme. Sidoqoftë, notat janë një element thelbësor në vendosjen

dhe mbajtjen e një standardi të përgjithshëm të cilësisë. Mësimdhënësit duhet t'i njohin dhe zbatojnë parimet dhe procedurat standarde të MASHT-it për vendosjen e notave. Shkolla duhet të ketë procedura për t'i verifikuar standardet e vëna nga mësimdhënësit, si dhe besueshmërinë e vlerësimit të tyre.

- 4.3. Frekuenca e notimit duhet të pasqyrojë rregullat e MASHT-it, dhe t'u përgjigjet nevojave për informim të palëve të interesit të shfaqura përmes rregullave të shkollës për vlerësim.
- 4.4. Mësimdhënësit dhe të tjerët që merren me vlerësim duhet t'i njohin dhe t'i përdorin dispozitat ligjore të MASHT-it, standardet për notim si dhe politikën e vlerësimit të shkollës.
- 4.5. Procedurat dhe kriteret për notim duhet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore dhe Kornizën e Kurrikulës Kombëtare të Kosovës
- 4.6. Mësimdhënësi, gjatë procesit të vlerësimit duhet të jetë i drejtë me të gjithë nxënësit, duhet t'i inkurajojë ata dhe jo të favorizojë, injorojë apo fyejë dikë në baza nacionale, gjinore, fetare, sociale, etj.
- 4.7. Mësimdhënësi, duhet t'i zbatojë të njëjtat kriteret gjatë procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, të njëjtat nga njëri nxënës tek tjetri dhe nga një situatë tek tjetra.
- 4.8. Nota duhet të bazohet vetëm në performancën aktuale që posedon nxënësi dhe nuk duhet të merren parasysh rrethanat tjera.
- 4.9. Procedurat për rezultatin dhe kategorizimin e arritjes duhet të jenë të përshtatshme me metodat e vlerësimit dhe duhet t'i ndjekin standardet dhe procedurat e dokumentuara.
- 4.10. Mësimdhënësi duhet të lexojë, kuptojë dhe t'iu përmbahet tërësisht udhëzimeve dhe kriterëve të vlerësimit.
- 4.11. Kur një pyetje (kërkesë), e një testi, merr pikë në mënyrë objektive (pyetje me shumë përgjigje), duhet të përgatitet edhe çelësi i notimit, që i jep përgjigjet e sakta dhe ky çelës duhet të përdoret gjatë dhënies së pikëve.
- 4.12. Kur një pyetje (kërkesë) është e hapur (subjektive) "përgjigje e konstruktuar" apo "kredit i pjesshëm" (d.m.th, e vlerësuar me dy apo më shumë pjesë pikësh), duhet të përgatitet skema e notimit. Përgjigjet model nuk duhet të përdoren.
- 4.13. Gjatë procesit të vlerësimit të pyetjeve (kërkesave) të hapura (subjektive) me "përgjigje të konstruktuar" apo "kredit të pjesshëm", vlerësuesi duhet t'i ndjekë gjithnjë udhëzimet në skemën e vlerësimit.
- 4.14. Vlerësuesi gjithnjë duhet ta ndjekë dhe të veprojë sipas skemës së vlerësimit. Nuk duhet ta vlerësojë një individ në bazë të gabimeve që nuk janë përfshirë në skemën e vlerësimit (nëse shkrimi i dorës nuk është kriter, nxënësit nuk i duhen ulur pikët për shkrim të keq).
- 4.15. Mësimdhënësi duhet t'i zbatojë të njëjtat kriteret gjatë vlerësimit të të njëjtave arritje nga një nxënës tek tjetri dhe nga një situatë tek tjetra.
- 4.16. Mësimdhënësi që e jep të njëjtën lëndë në të njëjtën klasë duhet të ketë pikë konsistente që krahasohen me punën sipas udhëzimeve dhe kriterëve të caktuar.
- 4.17. Kriteret e përdorura në vlerësim duhet të përcaktohen qartë dhe të jenë të bazuara në rezultatet mësimore të kurrikulës .
- 4.18. Çelësi apo skema e vlerësimit duhet të mbështetet vetëm mbi rezultatet mësimore të kurrikulës.

- 4.19. Skema e vlerësimit duhet të specifikojë cilat pika dhe sa kërkohen për të arritur kredit të plotë dhe sa kredit duhet dhënë për secilën përgjigje të pjeshme.
- 4.20. Gjatë dhënies së notave, mësimdhënësi duhet t'i ndjekë kriteret e dhëna në çelës apo në skemën e vlerësimit për ta zvogëluar në minimum subjektivitetin e notimit apo ndikimin e karakteristikave të parëndësishme apo jorelevante të përgjigjes.
- 4.21. Në rastin e vlerësimeve përmbyllëse, duhet të jenë procedura të thjeshta, transparente për të apeluar në notën e dhënë.
- 4.22. Në rastet kur nxënësi dhe prindërit nuk janë të kënaqur pasi nota e dhënë nuk reflekton drejt aftësinë e nxënësit, shkolla duhet të ketë dhe të implementojë një procedurë standarde ankimi për t'i shqyrtuar dhe zgjidhur ankesat në përputhje me ligjin dhe rregulloret tjera të vendosura nga MASHT-i apo Autoritetet Komunale të Arsimit.
- 4.23. Procedura e ankimit duhet të dokumentohet në rregulloren e shkollës dhe askujt nuk i duhet mohuar qasja në procedurë apo informacion rreth saj.
- 4.24. Nota duhet të bazohet në një mostër të mjaftueshme dhe përfaqësuese të përmbajtjes dhe të aktiviteteve të kryera në periudhën që i referohet vlerësimit, të dhënat dhe rëndësia e saj duhet të jenë të qarta.
- 4.25. Numri i pikëve që u jepet përmbajtjeve programore (njësive, temave apo lëmive të kurrikulës) duhet ta pasqyrojnë peshën që u është dhënë në skemën e vlerësimit dhe tabelën e specifikimeve apo planit të vlerësimit.
- 4.26. Në mënyrë që nxënësve t'u jepet mundësia që t'i tregojnë arritjet e tyre të plota, nota përfundimtare për një periudhë vlerësimi nuk duhet të mbështetet vetëm në një test apo vetëm në një metodë vlerësimi.
- 4.27. Aspekte të rëndësishme të të arriturave të nxënësve (njohuria, aftësia, shkathtësia, përpjekja, pjesëmarrja dhe sjellja) duhet të vlerësohen ndaras.
- 4.28. Gjatë procesit të vlerësimit të arritjes së nxënësit në objektivat e kurrikulës, nota e dhënë nuk duhet të marrë parasysh sjelljen e nxënësit, apo motivimin e tij/saj për të nxënë.
- 4.29. Objektivat e fushës emocionale (sjellja, qëndrimi, motivimi etj., qofshin të shpjeguara qartë në kurrikulë apo jo, mund të vlerësohen ndaras (për sjellje nxënësve u jepet notë e veçantë).
- 4.30. Shkolla duhet të ketë një sistem për verifikimin dhe sigurimin e cilësisë së notimit dhe standardeve të përcaktuara.
- 4.31. Të gjitha shkollat duhet të zhvillojnë dhe implementojnë një sistem për verifikim të brendshëm të notave, me role të përcaktuara dhe personel të kualifikuar. Ky sistem kontrollon kushtet dhe procedurat për dhënien e pikëve në vlerësim si dhe konfirmon saktësinë e rezultateve të raportuara.
- 4.32. Verifikimi i brendshëm duhet të udhëhiqet nga shërbimet profesionale të shkollës (pedagog-psikolog), si dhe duhet të përfshijë aktivet (këshillat) profesionale shkollore të mësimdhënësve.
- 4.33. Pas secilit vlerësim periodik apo në fund të vitit shkollor, verifikuesit e brendshëm duhet të nxjerrin një raport mbi cilësinë e dhënies së notave, të ndarë sipas gjinisë.

## 5. Standardi i pestë: SIGURIMI I INFORMACIONEVE TË NXJERRA NGA VLERËSIMI

- 5.1. Informacionet e nxjerra nga vlerësimi duhet të jenë me kohë, të qarta, të sakta, transparente, të ndara në bazë gjinore, të rëndësishme dhe të dobishme për përdoruesit.
- 5.2. Informacionet në lidhje me arritjet dhe rezultatet tjera duhen të raportohen për të gjitha palët e interesit (ku mund të përfshihen nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, qeverisja lokale, institucionet profesionale, MASHT-i, shoqëria civile dhe të tjerët). Informacioni i mbledhur nga vlerësimi i të nxënësve (vlerësimi përmbledhës) duhet të raportohet në lidhje me standardet dhe rezultatet kombëtare. Informacioni i mbledhur nga vlerësimi për nxënësve (vlerësimi formativ) duhet të raportohet në lidhje me objektivat e vendosura nga mësimdhënësit. Në të dyja rastet, forma dhe përmbajtja e raportimit duhet të jetë e përshtatur për nevojat e palëve të interesit, dhe të mbështetin përdorimin e atij informacioni.
- 5.3. Shkolla duhet të ketë një politikë të përcaktuar dhe sistem të zhvilluar për të siguruar informacion të vlerësimit për prindërit dhe palët tjera të interesit.
- 5.4. Politika e vlerësimit në shkollë duhet t'i specifikojë parimet që zbatohen gjatë vlerësimit si dhe informacionet që u jepen prindërve dhe palëve tjera të interesit, të drejtat dhe detyrimet e shkollës, mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve.
- 5.5. Mësimdhënësit, duhet ta implementojnë këtë politikë me respekt të duhur për nevojën për transparencë dhe komunikim të mirë në mes të shkollës dhe prindërve.
- 5.6. Informacionet në lidhje me rezultatet e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore, rregullat e shkollës dhe standardet e vlerësimit.
- 5.7. Mësimdhënësit, dhe të tjerët që kanë të bëjnë me vlerësimin duhet t'i njohin dhe t'i ndjekin dispozitat ligjore të MASHT-it dhe standardet për vlerësim si dhe politikën e vlerësimit në shkollë.
- 5.8. Aty ku qasja në informata nuk është rregulluar në mënyrë të shtjelluar nga MASHT-i, ajo duhet të përcaktohet me rregulloren e shkollës, në përputhje me dispozitat ligjore dhe me deklaratat e pranuar për të drejtat e njeriut / fëmijëve.
- 5.9. Gjatë marrjes së vendimeve për dhënie të informacionit duhet marrë parasysh se kujt dhe çfarë informacione duhet dhënë (prindërit duhet të kenë një shkallë të gjerë të informacionit rreth shkollimit të fëmijës së tyre në mënyrë që t'u ndihmojnë atyre ta përmirësojnë performancën apo sjelljen dhe të marrin vendime rreth progresit së tyre; MASHT-i ka nevojë për informacione rreth arritjeve të shkollës në tërësi dhe jo për nxënës individual, etj.).
- 5.10. Gjatë marrjes së vendimeve për të dhënë informacion, duhet shqyrtuar edhe qëllimi, forma, përmbajtja, niveli i detajeve, frekuenca, afati kohor dhe konfidencialiteti i tyre.
- 5.11. Drejtori i shkollës, shërbimi profesional i shkollës dhe mësimdhënësit, duhet të marrin pjesë në marrjen e vendimeve rreth llojeve të informacionit që duhet dhënë marrësve të tij, nëse kjo nuk parashihet me kornizën ligjore.

### 5.12. Vlerësimi i të nxënësve duhet të jetë i certifikuar.

- 5.12.1. Një certifikatë është deklaratë që një nxënës ka përfunduar me sukses një klasë të veçantë ose një kurs. Ajo duhet të sigurojë informacion të saktë për nivelin e arritjeve të nxënësve dhe referohet në rezultatet specifike.

- 5.12.2.Shkolla duhet të krijojë sisteme për të siguruar cilësinë e procesit të certifikimit. Këto sisteme duhet të dokumentohen dhe prova e kontrollit të cilësisë, të raportohet publikisht në fund të secilës periudhë mësimore.
- 5.12.3.Rezultatet specifike mësimore që janë certifikuar duhet të përmenden në certifikatë dhe të bëhen publike (në formën e një dokumenti mbi kurrikulën në një faqe interneti).
- 5.12.4.Parimet dhe kriteret për dhënien e notave duhet të shpjegohen në certifikatë.
- 5.12.5.Vetë certifikata duhet t'i shpjegojë parimet mbi të cilat bazohen notat dhe kuptimin e notave që janë vënë.
- 5.12.6.Përmbajtja e vlerësimeve e paraqitur në certifikatë duhet të përkufizohet nga dokumenti specifikues, i cili është publik (nga një faqe interneti), bashkë me shembujt e instrumenteve të vlerësimit.
- 5.12.7.Vlera e certifikatës, sa i përket se cilën njohuri dhe shkathtësi vërteton dhe për çfarë e certifikon bartësin e saj, sa i përket përparimit, duhet të bëhet publike (nga një faqe interneti).

### **5.13.Vlerësimi për nxënie duhet të raportohet.**

- 5.13.1.Raportimi duhet ta identifikojë përparimin, përshkrimin e përparësive dhe mangësive, dhe thekson pikat strategjike të mundshme për përmirësimin e arritjeve.
- 5.13.2.Dhënia e komenteve mund të jetë me gojë ose me shkrim; ajo duhet të jetë konstruktive si dhe pozitive, të identifikojë çfarë ka bërë nxënësi mirë ose jo mirë, çfarë duhet bërë për përmirësim dhe si duhet bërë si dhe të sugjerohen hapat e ardhshëm.

## **NENI 5**

### **KOMPETENCAT E MËSIMDHËNËSVE PËR VLERËSIM NË PAJTIM ME STANDARDET E VLERËSIMIT**

#### **1. Mësimdhënësi ka njohuri për:**

- 1.1. Politikën e shkollës dhe planin zhvillimor për vlerësim.
- 1.2. Planifikimin e vlerësimit si pjesë përbërëse e procesit të mësimdhënies.
- 1.3. Qëllimet e vlerësimit të bazuara në rezultatet mësimore të kurrikulës.  
Llojet e vlerësimit, qëllimin dhe funksionin e tyre në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit (vlerësimi për nxënie - vlerësimi formativ dhe vlerësimi i të nxënit – vlerësim përmbledhës).
- 1.4. Metodat dhe instrumentet e vlerësimit formativ (VpN) dhe atij përmbledhës (ViN).
- 1.5. Karakteristikat e vlerësimit cilësor (vlefshmëria, besueshmëria, objektiviteti dhe transparenca).
- 1.6. Kriteret e përzgjedhjes së metodave dhe instrumenteve të vlerësimit para mësimit, gjatë mësimit dhe pas mësimit.
- 1.7. Metoda dhe instrumente të shumëllojshme me qëllim të përshtatjes me nevojat dhe stilet e ndryshme të të nxënit.

- 1.8. Dispozitat ligjore të MASHT-it, rregulloret dhe udhëzimet në lidhje me vlerësimin formativ (VpN) dhe atë përmbledhës (ViN).
- 1.9. Vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm dhe standardet e të arriturave të ndërlidhura me to.
- 1.10. Instrumentet që mundësojnë identifikimin e të arriturave dhe dobësive me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies dhe nxënies.
- 1.11. Vlerësimin përmbledhës të bazuar në vlerësime të shumta dhe të ndryshme .
- 1.12. Zbatimin e kriterëve dhe standardeve të njëjta të vlerësimit me kolegët e të njëjtës fushë të njëjtës shkallë dhe të njëjtit nivel të përcaktuara me Kodin e Etikës së Vlerësimit.
- 1.13. Formimin e notës si rezultat të vlerësimit përmbledhës.
- 1.14. Dispozitat ligjore të MASHT-it rreth raportimit të rezultateve të vlerësimit dhe politikën e shkollës për raportimin e rezultateve.
- 1.15. Procedurat themelore për përpunimin dhe analizën e treguesve cilësorë dhe sasiorë të vlerësimit.
- 1.16. Mënyrën e raportimit të rezultateve të të arriturave dhe për palët e interesit në lidhje me informacionet për ato rezultate (nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, qeverisja lokale, institucionet profesionale, MASHT-i, shoqëria civile dhe të tjerët).
- 1.17. Sistemin e sigurimit të cilësisë së procesit të vlerësimit dhe transparencës së raportimit të vlerësimit.

## NENI 6

### Standardi I. PLANIFIKIMI I VLERËSIMIT

#### 1. Mësimdhënësi:

- 1.1. Planifikon vlerësimin në përputhje me rezultatet e pritshme të kurrikulës dhe me planin zhvillimor të shkollës.
- 1.2. Planifikon vlerësimin si pjesë përbërëse të mësimdhënies.
- 1.3. Bashkëpunon me aktivet (këshillat) e shkollës dhe shërbimet profesionale për planifikimin e vlerësimit (VpN dhe ViN) të bazuar në planin zhvillimor të shkollës.
- 1.4. Ndërlidhë qëllimet e vlerësimit me rezultatet mësimore të kurrikulës në të gjitha llojet e planifikimit.
- 1.5. Shfrytëzon të dhënat e vlerësimit në mënyrë sistematike për riplanifikimin e mësimdhënies dhe nxënies.
- 1.6. Planifikon kriteret e përzgjedhjes së metodave për vlerësimin para, gjatë dhe pas procesit mësimor.

### NENI 7

## Standardi II. PËRZGJEDHJA E METODAVE TË VLERËSIMIT DHE ZHVILLIMI I INSTRUMENTEVE

### 1. Mësimdhënësi:

- 1.1. Harton skema të përgjithshme dhe specifike të vlerësimit në përputhje me rezultatet mësimore të kurrikulës.
- 1.2. Vlerëson rezultatet mësimore të kurrikulës në të gjitha fushat ( e dijes, psikomotorike dhe afektive-emocionale).
- 1.3. Shfrytëzon në mënyrë të përshtatshme metoda dhe instrumente për vlerësimin e rezultateve mësimore.
- 1.4. Përzgjedhë metoda dhe instrumente të vlerësimit për të siguruar informacione të vlefshme, të besueshme dhe objektive.
- 1.5. Përdor metoda të shumta dhe të ndryshme të vlerësimit të përshtatshme për nxënësit e niveleve të ndryshme.
- 1.6. Përdor metoda dhe instrumente të shumëllojshme të vlerësimit me qëllim të përfshirjes të të gjithë nxënësve për t'i treguar tërësisht arritjet e tyre.
- 1.7. Analizon metodat dhe instrumentet e përzgjedhura të vlerësimit duke u bazuar në arritjet e nxënësve.
- 1.8. Reflekton për vlefshmërinë, besueshmërinë dhe cilësinë e përdorimit të metodave dhe instrumenteve të përzgjedhura të vlerësimit.

### NENI 8

## Standardi III. REALIZIMI I VLERËSIMIT

### 1. Mësimdhënësi:

- 1.1. U mundëson të gjithë nxënësve të demonstrojnë njohuri, aftësi, shkathtësi, qëndrime dhe vlera gjatë procesit të vlerësimit.
- 1.2. Ndjek parimet, rregullat, procedurat dhe standardet e planifikuara në planin e vlerësimit të shkollës.
- 1.3. I informon nxënësit për mënyrën e vlerësimit të punës së tyre dhe për kriteret e vlerësimit.
- 1.4. I njofton nxënësit për çdo ndryshim të procedurave dhe kriterëve të vlerësimit.
- 1.5. Shpjegon qartë format e vlerësimit me shembuj (modele) të përgjigjeve, punimeve, testeve, projekteve, etj.
- 1.6. Interpreton rezultatet e llojeve të ndryshme të vlerësimit dhe identifikon të arriturat dhe dobësitë.
- 1.7. Përdor rezultatet e VpN për orientimin e nxënësve në mësim të mëtutjeshëm.
- 1.8. Shkëmben me nxënësit qëllimet e mësimin dhe kriteret e suksesit në gjuhën që ata e kuptojnë.
- 1.9. Përdor informatën kthyesë me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.
- 1.10. Inkurajon përfshirjen aktive të nxënësve në mësim, vlerësimin e ndërsjellë dhe vetëvlerësimin.

- 1.10. Respekton dispozitat ligjore të MASHT-it dhe standardet relevante për vlerësimin formativ (VpN) dhe atë përmbledhës (ViN).
- 1.10. Krijon mjedis përkrahës për shprehje të lirë të nxënësve në lidhje me dobësitë dhe vështirësitë e të nxënësve të tyre gjatë VpN-së.
- 1.11. Krijon mjedis të përshtatshëm dhe kushte që nuk u pengojnë nxënësve t'i shfaqin arritjet e tyre gjatë ViN-së.
- 1.12. U mundëson nxënësve të marrin vendime për të nxënësit e tyre, e jo të jenë pranues pasiv të gjytimeve të tij.
- 1.15. Përgatit udhëzime të posaçme për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta.
- 1.13. Trajton nxënësit në mënyrë të barabartë në situata të ndryshme të vlerësimit, pa marrë parasysh dallimet gjinore, etnike, sociale, fetare, si dhe dallimet e sjelljeve apo stileve të të nxënësit.
- 1.14. Përdor programe kompjuterike për vlerësim (bankë të pyetjeve, teste kompjuterike, dosje (portfolio) elektronike, etj.).

## NENI 9

### Standardi IV. NOTIMI I NXËNËSVE

#### 1. Mësimdhënësi:

- 1.1. Zbaton me përpikëri rregulloren normative për formimin dhe vendosjen e notave.
- 1.2. Krijon standard gjithëpërfshirës të drejtë, real dhe të krahasueshëm me standardet e mësimdhënësve të tjerë në vendosjen e notave.
- 1.3. Formon notë përmbledhëse/përmyllëse, të vlefshme dhe objektive në bazë të informacioneve të mbledhura për të arriturat e nxënësit.
- 1.4. I përbahet skemës së notimit për përgjigjet e konstruara apo për shkrimin e një eseje.
- 1.5. Prezenton dhe shpjegon mënyrën e formimit të notës.

## NENI 10

### Standardi V. SIGURIMI I INFORMACIONEVE TË NXJERRA NGA VLERËSIMI

#### 1. Mësimdhënësi:

- 1.1. Zbaton dispozitat ligjore të MASHT-it dhe politikën e shkollës për informim të rezultateve të vlerësimit.
- 1.2. Raporton rezultatet e të arriturave të nxënësve për palët e interesit (nxënësit, prindërit, mësimdhënësit, qeverisja lokale, institucionet profesionale, MASHT-i, shoqëria civile dhe të tjerët).
- 1.3. Informon prindërit/kujdestarin në kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme për suksesin dhe ngecjet e fëmijëve të tyre, dhe i udhëzon ata si të ndikojnë në përmirësimin e atyre rezultateve.

- 1.4. Shpjegon rezultatet e nxënësve duke marrë parasysh kushtet në të cilat janë arritur ato (socio-ekonomike, kulturore etj.)
- 1.5. Përgatit raporte, dokumente për të arriturat në nivel të klasës ose të fushës mësimore dhe i interpreton ato.
- 1.6. Shqyrton veprime të ndryshme me qëllim të përmirësimit të vlerësimit.
- 1.7. Zbaton kritere dhe standarde për raportim të vlerësimit të përcaktuara me Kodin e Etikës së vlerësimit.
- 1.8. Kujdeset për besueshmërinë e informacioneve dhe përdorimin e drejtë të tyre.

### NENI 11

Ky Udhëzues pas nënshkrimit të tij nga ministri do të dërgohet në institucionet edukativo - arsimore si model pune.

  
Prof dr. Ramë Buja, ministër



